



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:275729
Datë: 11.12.2024
Numri i dokumentit: 06583247

ARJ.nr.83/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Beshir Islami dhe Zenel Leku, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, B.M., nga fshati R., Komuna e S., të cilin me autorizim e përfaqëson, Xhevat Balaj avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në P., me bazë juridike anulim i aktit administrativ të organit të paditur, nr.prot.813 të datës 27.02.2019 dhe nr.prot.626 të datës 14.02.2019, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të palës së paditur, ushtruar nga Avokatura Shtetërore, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA.nr.444/2023 të datës 22.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10 Dhjetor 2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga e paditura Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në P., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.444/2023, të datës 22.04.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.444/2023 të datës 22.04.2024, është vendosur si në vijim: **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.784/2019, i datës; 14.02.2023, **VËRTETOHET**.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.444/2023 të datës 22.04.2024, e paditura, nëpërmes të përfaqësuesit të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës

material dhe konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që: APROVOHET në tërësi kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.444/2023 të datës 22.04.2024, dhe të REFUZHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor ka ushtruar pala paditëse, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta refuzojë kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të vërtetojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimin të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditurës, përgjigjes së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin nr.0714 dhe nr. prot.626 të datës 14.02.2019, refuzohet mbështetja financiare për përkrahje në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2018, për nën masën 302.2 - Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare, pasi që aplikuesi nuk i plotëson kushtet siç përcakton Udhëzimi Administrativ nr.05/2018, për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2018 datë 08.03.2017. Ndërsa me Vendimin nr.0714 dhe nr. prot.813 të datës 26.02.2019,(data sipas vulës së protokollit 27.02.2019), të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, refuzohet ankesa e fermerit B.M., si e pabazuar dhe e pa argumentuar, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1.5 dhe 1.6 të UA nr/05/2018. Në arsyetim të vendimit kontestues theksohet se: Gjatë shqyrtimit të ankesës në pikat në të cilat fermeri është ankuar, komisioni ka konstatuar se në bazë të raportit të kontrollës pas kërkesës së palës është konstatuar se objekti i ri i paraparë nuk është ndërtuar në vendin e caktuar, mirëpo fermeri ka bërë renovimin e një objekti ekzistues në një lokacion tjetër, (e deklaruar edhe nga vetë fermeri në ankesë). Gjithashtu disa nga pajisjet e blera, (rezervat-kazanat) janë konstatuar me kontrollë në terren se janë të vjetra (të përdorura) dhe nuk janë investime të pranueshme për AZHB.

Kundër vendimit të lartë cekur paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.784/2019, të datës 14.02.2023, në dispozitiv ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET në tërësi si e bazuar padia e paditësit B.M., nga fshati R., Komuna e S. II. ANULOHET vendimi i të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) - Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), Nr. prot.813 i datës 27.02.2019 si dhe vendimi nr. prot. 626 i datës 14.02.2019 si të kundërligjshëm. III. OBLIGOHET e paditura MBPZHR - AZHB, që paditësit në emër të financimit për projektin investues të zhvillimit rural, paditësit t'ia paguajë shumën prej 19,500.00 (nëntëmbëdhjetëmijë e pesëqind) Euro, duke ia llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8%, nga data e paraqitjes së padisë 01.04.2019, në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor. IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Në bazë të shkresave të lëndës, konkretisht procesverbalit mbi kryerjen e kontrollit inspektues Nr. 2260 të datës 16.10.2018, është vërtetuar se paditësi fillimisht është pajisur me leje të rrënimit dhe ka filluar rrënimin e objektit ekzistues. Po ashtu, në bazë të shkresave të lëndës, vërtetohet se paditësi është pajisur me leje mjedisore për ndërtimin e objektit - bodrumit për përpunimin e rrushit, në parcelën kadastrale me numër P-7.....-....., Në bazë të konstatimeve të inspektorëve gjatë kontrollit të dytë të datës 27.12.2018, paditësi nuk e ka ndërtuar objektin në vendin e paraparë nga komisioni paraprak, mirëpo ka bërë renovimin e objektit ekzistues, duke vendosur dyer dhe dritare nga plastika. Po ashtu, në bazë të këtij raporti, është konstatuar se pajisjet për shtrydhjen e rrushit janë të vjetra. Neni 32 i Udhëzimit Administrativ Nr.02/2017 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2017, përcakton se: *“Për kontrollën e dytë në terren, në rastet e projekteve të ujitjes, të investimeve në ndërtimtari dhe investimeve që kërkojnë ekspertizë të veçantë, AZHB mund të angazhojë ekspertë të fushave përkatëse për të dhënë vlerësim profesional”*. Me aktvendimin C.nr.23/19 të datës 02.08.2019, të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, është aprovuar propozimi i propozuesit për sigurimin e provave si dhe është vërtetuar se propozuesi këtu paditësi, gjatë implementimit të projektit iu ka përmbajtur kontratës Nr. 9/2018 të datës 06.09.2018. Sipas këtij aktvendimi, gjendja faktike është vërtetuar me ekspertiza përkatëse të ndërtimtarisë dhe të makinerisë, të cilët kanë konstatuar se paditësi ka rrënuar objektin e vjetër sipas lejes për rrënim e për të cilin është hartuar raport nga ana e inspektionit komunal si dhe ka ndërtuar objektin e ri konform kontratës së lidhur me të paditurën.

Tutje theksohet se: Sipas ekspertizës është konstatuar se makineria e blerë nga ana e paditësit, për të cilat ka ofruar edhe faturat përkatëse, i plotëson kushtet e parapara në planin e biznesit dhe janë sipas parametrave të kërkuar. Në këtë kuptim, gjykata konstaton se në bazë të ekspertizave të caktuara sipas gjykatës në aktvendimin e lartëcekur, paditësi i është përmbajtur kushteve të kontratës, sipas Planit të Biznesit të cilën e ka paraqitur me kërkesë. E paditura konform dispozitave të lartcekura të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2017, ka pasur mundësi të caktojë ekspertiza përkatëse, mirëpo që gjendjen e ka konstatuar vetëm përmes inspektorëve të kontrollës, përderisa gjendje tjetër faktike është vërtetuar me anë të ekspertizave pranë gjykatës për sigurimin e provave. Andaj, konstatimet si në raportin e inspektorëve të datës 27.12.2018, gjykata vlerëson se janë në kundërshtim me gjendjen e vërtetuar nga ana e ekspertëve si në Aktvendimin C.nr.23/19 të datës 02.08.2019 si dhe provave në shkresat e lëndës, ku ekzistojnë leja e rrënimit dhe leja e ndërtimit. Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin pretendimet e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Çdo palë ndërgjyqëse detyrohet të paraqesë shkresat që ka përdorur për të provuar thëniet e veta. Pala e paditur ka pretenduar se paditësi nuk e ka ndërtuar objektin e ri mirëpo ka bërë vetëm renovim të objektit të vjetër si dhe pajisjet për shtrydhjen e rrushit kanë qenë të vjetra, mirëpo që këto pretendime nuk i kanë mbështetur me prova të cilat do të vërtetonin një gjendje tjetër faktike nga ajo që ka vërtetuar gjykata në bazë të provave të prezantuara nga paditësi si dhe gjendjes faktike të vërtetuar me Aktvendimin C.nr.23/19 të datës 02.08.2019.

Gjykata e shkallës së parë në vazhdim konstaton se gjykata në konfliktin administrativ vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike. Gjykata vërtetoi gjendje tjetër faktike, përmes provave të administruara në këtë shqyrtim dhe konstatoi se vendimi i të paditurës i pabazuar në prova relevante, është i kundërligjshëm dhe si rrjedhojë vendosi që i njëjti të anulohet dhe të obligohet e paditura që paditësit t'ia bëjë kompensimin në emër të përkrahjes materiale për projektin e zhvillimit rural sipas kontratës Nr.92/2018. Andaj konform nenit 43 par.3 lidhur me nenin 46 par. 4, e vendosi vet çështjen administrative dhe vlerësoi se padia duhet të aprovohet në tërësi dhe paditësit t'i njihet e drejta në kompensim në shumën prej 19,500.00 (nëntëmbëdhjetëmijë e pesëqind) Euro, aq sa ka qenë obligimi i të paditurës për përkrahje materiale, meqenëse baza juridike i është krijuar me aprovimin e kësaj padie. Po ashtu, gjykata lidhur me kamatën ligjore prej 8% është bazuar në dispozitat e nenit 382 të Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe si datë të fillimit ka marrë datën e paraqitjes së padisë në gjykatë e që është data 01.04.2019, e deri në pagesën definitive”.

Gjykata e Apelit në Prishtinë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe 194 dhe 195 paragraf 1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Në arsyetim të aktgjykimit të saj ndër të tjera arsyeton se: Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit gjykata e shkallës së parë ka qenë e lidhur me aktvendimin e nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, për faktin se me të njëjtin aktvendim është vërtetuar gjendje krejt tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga Inspektorët e të paditurës me rastin e inspektimit të paditësi më datë;27.12.2018, dhe se i njëjti aktvendim është i formës së prerë dhe duhet patjetër të zbatohet nga Gjykata, përkatësisht, të merret si provë vendimtare për t'iu njohur e drejta e kërkuar nga paditësi. Pavarësisht nga ajo se në procedurën e marrjes së provës a ka kompetencë Gjykata që më aktvendim të vërtetoj gjendjen faktike, apo vetëm të caktoj ekspert për nxjerrjen e provës, kur ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj sipas nenit 379 të LPK-së. Kolegji i apelit vëren se nga provat të cilat gjinden në shkresat lëndës nuk shihet se e paditura ka ushtruar ndonjë mjet të jashtëzakonshëm juridik për të rishqyrtuar eventualisht ligjshmërinë e këtij aktvendimi të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, C.nr.23/19, të datës 02.08.2019, në Gjykatën Supreme të Kosovës, përmes kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë drejtuar, Prokurorit të Shtetit. Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, vlerësoj se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat materiale dhe procedurale me rastin e aprovimit të kërkesë padisë së paditëses andaj në kuptim të nenit 49 të LKA-së dhe 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar, shkresave të lëndës dhe

vlerësimin të pretendimeve në kërkesë, gjeti se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vepruar kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuar nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave zbatim të gabuar të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala e paditur në kërkesën e saj. E paditura, nuk ka paraqitur pretendime tjera për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës prandaj, Gjykata Supreme është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së, lidhur me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt, për të cilat ka gjetur se aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira. Në logjikën e njëjtë juridike nuk është pranuar as pretendimi për shkelje të dispozitave thelbësore të procedurës kontestimore nga gjykata e shkallës së parë, sepse nga ekzaminimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë rezulton se gjykata i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe e ka arsyetuar aktgjykimin e saj sipas pretendimeve të paraqitura, por edhe sipas bazave për cilat sipas detyrës zyrtare duhet të ekzaminohet aktgjykimi. Aktgjykimet e kontestuar përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me aprovimin si të bazuar të kërkesë padisë së paditësit. Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, ka rezultuar se vendimet e të paditurës nr.0714 dhe nr. prot.813 të datës 26.02.2019, dhe nr. prot. 626 i datës 14.02.2019 të MBPZHR, nuk janë vendime të drejta dhe të ligjshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, njëjtë sikurse gjykatat e instancave më të ulëta vlerëson se paditësi me prova konkrete ka dëshmuar se ka përmbushur kushtet e kontratës Nr. 9/2018 të datës 06.09.2018, me anë të sigurimit të provës mbi gjendjen faktike të konstatuar në terren sipas aktvendimit CN.nr.23/19 të datës 02.08.2019, i plotëfuqishëm sipas vulës së plotëfuqishmërisë me datë 01.08.2022,dhe përmes ekspertizave të punuara nga fusha e ndërtimtarisë dhe të makinerisë, me të cilën është vërtetuar se paditësi ka ndërtuar objektin (podrumin e verës) në parcelën kadastrale P--...-., në përmasa si në kontratë dhe se ka blerë makina për shtrydhjen e rrushit dhe ndarjen e kokrrave të rrushit si dhe pompa për bartjen e lëngut nga një vend tjetër të markës të gjitha sipas karakteristikave teknike makina të reja (të papërdorura).

Gjykata shqyrtoj pretendimet e tjera parashtrueses së kërkesës, por vlerësoj se të njëjtat janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosje ndryshe në këtë çështje nga çka kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes në mënyrë meritore, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Vendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Përveç kësaj, edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditurës.

Gjykata nuk shqyrtoi pretendimet në kërkesë lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se, sipas dispozitës së nenit 24 paragraf 2 të LKA-së, përcaktohet se: *“Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes”*.

Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflike Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.83/2024, më datë 10 Dhjetor 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani